Kronikë

Dibër, dhunoi dhe kërcënoi gruan se do e vriste, arrestohet 38-vjeçari! Në banesë iu gjet një pistoletë dhe 3 granata

Një 38-vjeçar është vendosur në pranga nga policia e Dibrës pasi dhunoi dhe kërcënoi gruan se do e vriste.

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

[Sh.com] Redaksia
19 Mars, 13:13 | **Përditesimi: 19 Mars, 13:25**

Share

Dibër- Një 38-vjeçar është vendosur në pranga nga policia e Dibrës pasi dhunoi dhe kërcënoi gruan se do e vriste.

Emri Mera u arrestua në banesën e tij në fshatin Lishan, pas kallëzimit në polici nga bashkëshortja e tij.

Gjatë kontrollit të kryer blutë bëjnë me dije se gjetën dhe sekuestruan 1 armë zjarri pistoletë, 3 granata dore të montuara me kapsolla ndezëse, 1 krehër pistolete dhe një sasi municioni luftarak.

LEXO EDHE:
Dibër/ Apeli e kishte dënuar me formë të prerë për dy krime, arrestohet 57-vjeçari nga Tirana! Hajdutët bastisin marketin gjatë natës në Klos

> *"Shërbimet e Komisariatit të Policisë Dibër, në bashkëpunim me shërbimet e Forcës së Posaçme "Shqiponja", pas njoftimit nga një 38-vjeçare se në banesë, në fshatin Lishan, njësia administrative Luzni, bashkëshorti i saj po e dhunonte dhe po e kërcënonte për ta vrarë, kanë shkuar menjëherë në adresën e dhënë.*
>
> *Si rezultat i veprimeve të shpejta profesionale të shërbimeve të Policisë u kap dhe u vu në pranga shtetasi Emri Mera, 38 vjeç, banues në fshatin Lishan", thuhet në njoftimin e policisë.*

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë Dibër, për veprat penale "Dhuna në familje", "Kanosja" dhe "Mbajta pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit".

Xh.K/r.k./Shqiptarja.com

TAG: Dibër | Emri Mera | dhune ne familje

Komento

Komente

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH .COM

Sondazhi i ditës:
Nisin kualifikueset e Botërorit, si del Angli-Shqipëri?

20 Mars, 10:18

Fiton Anglia | Barazim | Fiton Shqipëria

Lajme të tjera

Fier/ Nipi dhunon gjyshen, 41-vjeçari plagos të afërmin me thikë! Policia i arreston të dy, në pranga edhe shoferi i dehur (EMRAT)
20 Mars, 10:03

Ushtronte dhunë ndaj bashkëshortes dhe ngacmonte seksualisht të miturën, Prokuroria e Fierit dërgon për gjykim autorin
19 Mars, 10:41

Hapja e tunelit të Murrizit, Rama: Na e mori shpirtin derisa e lidhëm krejt si duhej Rrugën e Arbrit! Qytetarët: U plotësua ëndrra shekullore e dibranëve
16 Mars, 08:46

Në 'top listën' e më të kërkuarve në Itali prej 1999, kapen dy kushërinjtë e dënuar për vrasje! Fshiheshin në Dibër me identitet të rremë
15 Mars, 09:57

Rama për hapjen e Tunelit të Murrizit: Jam çliruar nga një makth i vërtetë, sot mbaroi 'Odisea'
14 Mars, 19:58

Mickoski, i 'bezdisur' nga inagurimi i Tunelit të Murrizit: Ku është lidhja hekurudhore e Durrësit me Qafë Thanën?
14 Mars, 17:18

Pas 6 vitesh punë, hapet tuneli i Murrizit! 2 orë nga Tirana në Dibër, banorët: Efekt ekonomik, eja të shijoni natyrën dhe mikpritjen dibrane
14 Mars, 07:55

Aksident tragjik në aksin Bulqizë-Shupenzë/ Fuoristrada me 6 familjarë del nga rruga, humb jetën nëna! Burri, 3 fëmijët dhe e afërmja e tyre transportohen drejt Traumës (VIDEO)
13 Mars, 21:58

Tuneli i Murrizit hapet nesër, Rama: Dibra bëhet lagjja e gjelbër e Tiranës
13 Mars, 19:08

Çmontohet grupi që shiste drogë lokaleve të Tiranës dhe e trafikonin në Kosovë, 'Tentakulat' prangosin 5 persona, 5 të tjerë shpallen në kërkim (EMRAT)
13 Mars, 13:39

Kryetarët në garë për deputet! Ligji e lejon, më 11 maj mund të votohet edhe për Kuvendin e ri edhe për 3 bashkitë
12 Mars, 20:00

Kandidatët e Partisë Socialiste për Dibrën/ Klosi bën publik emrat! 2 në listë të mbyllur, 6 garojnë për herë të parë
12 Mars, 19:58

© 2011 - 2025 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje